

SKK15 SHËNIM SHPJEGUES

Shënimet shpjeguese për Standardet e Kontabilitetit të Kosovës kanë për qëllim të japin informacion shtesë për Standardet dhe udhëzime teknike për sa i përket përdorimit dhe zbatimit të tyre. Në rast të ndonjë divergjence ndërmjet Shënimeve Shpjeguese dhe Standardeve, janë Standardet ato që mbizotërojnë

Pasuritë e patrupëzuara janë pasuri të identifikueshme jomonetare, të patrupëzueshme, që pritet të përdoret për më shumë se një vit në prodhimin apo furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, për dhënie me qira të tjerëve, ose për qëllime administrative.

Pasuritë e patrupëzuara i kontrollojnë ndërmarrja duke u mbështetur në të drejtat ligjore dhe ato përfshijnë: patentat, licencat, pronën intelektuale, markën, llojin e produktit, titujt botues, të drejtën ekskluzive mbi produktin, softverët kompjuterikë, të drejtat e autorit, listat e konsumatorëve dhe të drejtat e marketingut.

Parimet bazë të kontabilitetit për pasuritë e patrupëzuara

Kontabiliteti për pasuritë e patrupëzuara përfshin të njëjtat parime të kontabilitetit që zbatohen për pasuritë e trupëzuara, siç janë prona, impianti dhe pajisjet. Me pak fjalë, këto parime janë:

- ? Në marrje, zbatimi i parimit të shpenzimeve.
- ? Gjatë periudhës së përdorimit, zbatimi i parimit të përputhjes, i cili kërkon që shpenzimet që bëhen dhe të ardhurat që nxirren nga ato shpenzime duhet të aprovohen në të njëjtën kohë.
- ? Gjatë heqjes nga përdorimi, zbatimi i parimit të aprovimit të të ardhurave, nën të cilin një fitim apo një humbje aprovohet në heqje të barabartë me diferencën ndërmjet konsideratës së pranuar dhe vlerës së regjistrimit të pasurisë së hequr nga përdorimi.

Në përputhje me parimin e shpenzimeve, pasuritë e trupëzuara duhet të regjistrohen në marrje me koston e tyre aktuale në para të gatshme. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet e bëra për ta marrë pasurinë, duke përfshirë çmimin e blerjes, transferin dhe tarifën ligjore si dhe të gjitha shpenzimet tjera të lidhura me marrjen.

Amortizimi i një pasurie të patrupëzuar zakonisht kërkon një të hyrë harmonizuese në fund të vitit. Shuma që do të amortizohet regjistrohet si debit i shpenzimeve të amortizimit dhe drejtpërdrejt si kredit i kontos së pasurisë së patrupëzuar.

Aprovimi i Pasurive të Patrupëzuara

Pasuritë e patrupëzuara vlerësohen ngjashëm me pronën, impiantet dhe pajisjet përveç se çvlerësimi quhet amortizim. Një pasuri e patrupëzuar aprovohet vetëm kur kostoja e saj ndaj ndërmarrjes mund të matet në mënyrë të sigurtë. Nëse blehet një pasuri e patrupëzuar, të gjitha shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me blerjen mund t'i shtohen kostos së pasurisë.

Nëse një pasuri e patrupëzuar zhvillohet në brendësi, mund vlerësohet duke iu referuar shpenzimeve që janë bërë për këtë qëllim. Shpenzimet që janë bërë dhe janë aprovuar si shpenzime në periudhat e mëhershme mund të mos deklarohen përsëri si pasuri.

Shuma e çvlerësueshme e një pasurie të patrupëzuar duhet të amortizohet brenda afatit të përdorimit të saj, ose njëzet vjet nga data e aprovimit fillestar. Një kohë më e gjatë se njëzet vjet mund të justifikohet nëse pasuria i është nënshtruar një të drejte ligjore për një periudhë më të gjatë, dhe ose nuk mund të ndahet nga një pasuri specifike e trupëzuar me një afat të përdorimit së paku më të gjatë, ose ekziston një treg aktiv dytësor për pasurinë në fjalë.

Kur një pasuri e patrupëzuar shitet, këmbëhet, ose hiqet nga përdorimi në një mënyrë tjetër, çmimi i saj i paamortizuar (ose çmimi neto i amortizimit të akumuluar, nëse është regjistruar veçmas) duhet të hiqet nga kontot dhe të regjistrohet një fitim apo humbje në dispozicion.

Dobësimi i vlerës së Pasurive të Patrupëzuara

Gjatë periudhës në të cilën përdoret një pasuri e patrupëzuar ose një borxh i shtyrë ka vlerë bartese në pasqyrën e bilancit, një kontrollim periodik i vlerës së përfitimeve të ardhshme që lidhen me pasurinë mund të tregojë që vlera e tashme e regjistrave e kalon dobishmërisë ekonomike (vlerën e vazhdueshme në përdorim) për ndërmarrjen. Në të tilla raste, çmimi i paamortizuar duhet të shënohet, dhe të aprovohet një humbje. Vlera e përmirësuar duhet të amortizohet gjatë afatit të vlerësuar të dobishmërisë së saj, duke mos kaluar 20 vjet nga data e përvetësimit. Kur ndodh të bëhet një shënim për shkak të dobësimit të vlerës, kërkohet shpallje në shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare.

Patentat

Patenta është një e drejtë ekskluzive e njohur me ligj dhe e regjistruar me juridiksion legal. E drejta patentore i mundëson mbajtësit ta përdorë, manufaktojë, shesë dhe kontrollojë objektin, procesin apo aktivitetin që e mbulon patentën, pa ndërhyrje dhe pa shkelje nga të tjerët. Në realitet, regjistrimi i patentës në zyrën përkatëse të qeverisë nuk është garanci për mbrojtje. Patenta nuk vërtetohet përderisa nuk është mbrojtur me sukses në gjyq. Për këtë arsye,

ekziston një marrëveshje e përgjithshme që shpenzimet e mbrojtjes së suksesshme në gjyq duhet të kapitalizohen si pjesë e patentës. Nëse mbrojtja nuk ka sukses, shpenzimet ligjore, si dhe çmimi i paamortizuar i patentës, anulohet. Shuma bartëse e patentës reduktohet deri në shumën e saj të dobësuar, e cila mund të jetë zero. Humbja nga dobësimi duhet të debitohet për shumën e çdo regjistrimi.

Shembull i kontabilitetit të patentës

Kompania e Kurthave për Minj ka zhvilluar një tip të ri të kurthës. Kompania e Kurthave për Minj bën prodhimin e kurthave për minj dhe ka për qëllim ta shtojë kurthën e re në rendin e prodhimeve të saj që i ofron për shitje. Kontabilistët e kompanisë kanë vendosur që shpenzimet për rrogat e punëtorëve, të materialit, të testimi dhe shpenzimet e tjera të punës që janë të lidhura me kurthën e re përfshijnë 120,000. Pasi që këto janë shpenzime të zhvillimit (punës) totali prej 120.000 do të njihet si pasuri e patrupëzuar.

Tre vjet më vonë, Kompania e Kurthave për Minj ia shiti një patentë të kurthës së saj të re Kompanisë Critter Catcher. Critter Catcher pagoi 160.000 për patentën. Patenta zgjat njëzet vjet. Kompania e Kurthave për Minj do ta llogarisë dhe ta aprovojë një përfitim në shitjen e pasurisë së patrupëzuar, e cila është e barabartë me diferencën ndërmjet vlerës së amortizuar të pasurisë pas tri vitesh dhe të 160.000 e pranuar. Critter Catcher do ta regjistrojë në regjistrat e saj të kontabilitetit një pasuri të patrupëzuar prej 160.000.

Dy vjet më vonë, një kompani tjetër, Rodent Ridders, i ofroi Critter Catcher që t'ia blejë patentën për 200,000. Critter Catcher vendosi që të mos e shesë, pasi që ai ishte produkti i tyre më i suksesshëm. Rodent Ridders filloi të shesë një produkt të ngjashëm dhe Critter Catcher e paditi për ta mbrojtur patentën e vet. Padia pati sukses, por kushtoi 18,000. Critter Catcher do t'i kapitalizojë shpenzimet ligjore në pasurinë e patrupëzuar të patentës dhe do ta amortizojë koston shtesë gjatë afatit të mbetur të patentës.

Të drejtat e autorit

E drejta e autorit është një formë e mbrojtjes që u jepet me ligj autorëve të veprave letrare, muzikore, artistike, dhe të ngjashme. Pronarët e të drejtës së autorit gëzojnë disa të drejta ekskluzive, duke përfshirë të drejtën për të shtypur, rishtypur dhe kopjuar veprën, për të shitur dhe shpërndarë kopje dhe për ta ekzekutuar dhe incizuar veprën.

Siç pritet, çmimi i të drejtës së autorit vlerësohet në përputhje me parimin e kostos. E drejta e autorit shpesh nuk ka vlerë ekonomike gjatë tërë afatit të saj ligjor. Çmimi i të drejtës së autorit duhet të amortizohet brenda periudhës në të cilën zëri i përfshirë në këtë të drejtë pritet të prodhojë të ardhura. Megjithatë, sido që të jetë e drejta e autorit nuk duhet të amortizohet gjatë kohës përtej kalimit të afatit të saj ligjor.

Markat dhe Emrat e Prodhimeve

Markat dhe/ose emrat e prodhimeve (si psh Coca-Cola) janë emra, simbole ose identitete të tjera distinktive që u jepen kompanive, prodhimeve dhe shërbimeve. Ato regjistrohen për të ndihmuar vërtetimin e pronësisë. Markat dhe emrat e regjistruar mund të ripërtëriten, duke zgjatur kështu afatet e tyre për kohë të pacaktuar. Në këtë mënyrë, emrave, simboleve apo identiteteve të tjera distinktive u jepet mbrojtje ligjore.

Shuma ekuivalente në para të gatshme që paguhet për blerjen e një marke duhet të kapitalizohet. Shumat e shpenzuara drejtpërdrejt në zhvillim, ruajtje, ekspandim, regjistrim ose mbrojtje të një marke duhet të kapitalizohen. Shumat e tilla të kapitalizuara duhet të amortizohen gjatë afatit të përdorimit të markës ose 20 vjetësh, cilado periudhë që është më e shkurtër.

E drejta ekskluzive

Të drejtat ekskluzive (siç janë ato për një kompani televizive) shpesh jepen nga njësitë qeveritare për të dhënë të drejtën për të përdorur prona publike ose për të bërë furnizimin me shërbime publike (si rrymë), si dhe nga entitet biznesore për të drejtën për të përdorur një emërtim dhe shërbime specifike (si psh MacDonalds). Secila e drejtë ekskluzive specifikon një periudhë kohore brenda së cilës ajo është e vlefshme, si dhe të drejtat dhe obligimet e dhënësit dhe marrësit të saj. Çmimi i marrjes së të drejtës ekskluzive shpesh është i lartë dhe zakonisht kërkon pagesën e një tarife paraprake që marrësi duhet t'ia paguajë dhënësit. Çmimi paraprak i të drejtës ekskluzive duhet të kapitalizohet dhe pastaj të amortizohet si shpenzim. Nëse kjo e drejtë vlen për një periudhë të shkurtër kohe, çmimi i saj duhet të amortizohet gjatë asaj periudhe në mënyrë racionale dhe sistematike. Nëse afati është i pacaktuar, amortizimi duhet të bazohet në një afat të paracaktuar në mënyrë të sigurtë, me vlerësime periodike. Këto vlerësime përcaktojnë nëse paracaktimi ka nevojë të ripërtëritet, megjithatë, periudha e amortizimit total nuk mund të kalojë 20 vjet.

Pagesat vjetore dhe kurentet të marrësit të së drejtës ndaj dhënësit, për shërbime siç janë ndihma në kampanja promovionale, kontabiliteti, dhe çështjet organizative, duhet t'ia paguajë marrësi sepse ato nuk krjojnë përfitim të matshëm në të ardhmen për të drejtën ekskluzive. Nëse kjo e drejtë bëhet e pavlefshme ose anulohet me ligj, shumat e paamortizuara duhet të fshihen menjëherë si dobësim i vlerës së pasurisë.

Shpenzimet e Hulumtimit dhe Të Zhvillimit

Hulumtimet janë hetime origjinale dhe të planifikuara që ndëmerren për të fituar dhe kuptuar njohuri të reja shkencore apo teknike. Shembuj janë aktivitetet që kanë për qëllim marrjen e njohurive të reja, kërkimin e zbatimit të gjetjeve nga

hulumtimi apo të njohurive të tjera, kërkimet e alternativave të prodhimit apo përpunimit, dhe formulimin dhe projektimin e alternativave të mundshme të reja ose të përmirësuara të prodhimit apo përpunimit. Shpenzimet e hulumtimit duhet të ngarkohen si shpenzime ashtu si janë shpenzuar dhe të mos kapitalizohen. Zhvillimi është zbatim i rezultateve nga hulumtimi apo të njohurive tjera për një plan ose projekt të prodhimit të materialeve, mjeteve, prodhimeve, proceseve, sistemeve apo shërbimeve të reja apo thelbësisht të përmirësuara, para fillimit të prodhimit apo shfrytëzimit komercial. Aktivitetet e zhvillimit në mënyrë tipike përfshijnë vlerësimin e alternativave të prodhimit apo përpunimit, projektin, konstruktimin dhe testimin e prototipeve dhe modeleve para prodhimit, projektimin e mjeteve, shablloneve, kallëpeve, dhe stampave që përfshihen në teknologjinë e re, dhe projektimin, konstruktimin dhe vënien në punë të një versioni parapak që nuk është i shkallës ekonomike të arsyeshme për prodhim komercial. Shpenzimet e zhvillimit duhet të kapitalizohen si pasuri bazuar në kritere të caktuara.

Kriteret për kapitalizimin e shpenzimeve të zhvillimit janë:

- ? Produkti apo procesi janë të definuar qartë dhe shpenzimet e atribuara mund të veçohen të identifikohen dhe të maten në mënyrë të sigurtë.
- ? Realizueshmëria teknike e produktit apo procesit është e demonstrueshme.
- ? Ndërmarrja ka ndërmend ta prodhojë dhe nxjerrë në treg, ose përdorim, produktin apo procesin.
- ? Është e demonstrueshme ekzistenca e tregut për atë product apo proces, ose nëse do të përdoret brenda ndërmarrjes, atëherë dobishmëria e saj për ndërmarrjen.
- ? Ekzistojnë resurse adekuate, ose mund të demonstrohet ekzistenca e tyre, të cilat nevojiten për ta kryer projektin dhe shitjen apo përdorimin e produktit apo procesit.

Shuma e shpenzimeve të zhvillimit që është aprovuar si pasuri duhet të amortizohet dhe të njihet si shpenzim në baza sistematike ashtuqë të reflektojë strukturën në të cilën janë aprovuar përfitimet përkatëse ekonomike. Zakonisht ato amortizohen në një bazë sistematike deri në 20 vjet, përveç nëse mund të përcaktohet në mënyrë specifike një afat më i gjatë i përdorimit.

Identifikimi i Shpenzimeve të Hulumtimit dhe Zhvillimit

Më poshtë janë të renditura shembuj të aktiviteteve tipike që përfshihen në hulumtim, si dhe të aktiviteteve që nuk përfshihen në zhvillim.

Aktivitetet tipike që përfshihen në hulumtim:

- ? Hulumtimet laboratorike me qëllim të zbulimit të njohurive të reja
- ? Të kërkuarit e zbatimit të zbulimeve nga hulumtimet ose të njohurive tjera
- ? Formulimi konceptual dhe projektimi i alternativave të mundshme të prodhimeve apo proceseve

Aktivitetet tipike që përfshihen në zhvillim:

- ? Testimi i kërkimeve, ose vlerësimeve të alternativeve të prodhimit apo procesit.
- ? Projektimi, konstruktimi dhe testimi i prototipeve dhe modeleve para prodhimit.
- ? Projektimi i veglave, shablloneve, kallëpeve dhe stampave që përfshihen në teknologjinë e re

Aktivitetet tipike që përjashtohen nga hulumtimi dhe zhvillimi:

- ? Vazhdimi logjik teknologjik në një fazë të hershme të prodhimit komercial
- ? Kontrolli i kualitetit gjatë prodhimit komercial, duke përfshirë testimin rutinor të produkteve
- ? Përdorimi i ekspertizës gjatë rënive gjatë prodhimit komercial
- ? Modifikimet periodike të produkteve ekzistuese, linjave të prodhimit, proceseve manufakturoese dhe veprimeve tjera në zhvillim, edhe nëse modifikimet e tilla mund të përfaqësojnë përmirësim.
- ? Përshtatja e aftësive ekzistuese për kërkesa apo nevoja të caktuara të konsumatorit si pjesë e aktivitetit të vazhdueshëm komercial
- ? Projektimi Routing (**përktimi është lënë me qëllim**)i veglave,shablloneve, kallëpeve dhe stampave.
- ? Aktivitetet, përfshirë projektimin dhe teknologjinë e konstruktimit, të lidhura me konstruktimin, rivendosjen, risistemimin ose fillimin e punës së objekteve ose pajisjeve të cilat të vetmin përdorim e kanë në një hulumtim të veçantë dhe projekt të zhvillimit.

Udhëzimet në kontabilitet për hulumtim dhe zhvillim:

1. Shpenzimet e hulumtimit duhet të ngarkohen si shpenzime të periudhës në të cilën ato kaë ndodhur.
2. Shpenzimet e zhvillimit duhet të shtyhen për periudha në të ardhmen vetëm nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:
 - ? Produkti ose procesi është i definuar qartë dhe shpenzimet e lidhura me të janë të identifikueshme.
 - ? Realizueshmëria teknike e produktit ose procesit është vërtetuar.
 - ? Menagjimi i ndërmarrjes ka bërë të qarta qëllimet e tij për ta prodhuar dhe shitur, ose përdorur, produktin apo procesin.
 - ? Ekziston një treg i ardhshëm i definuar qartë për shitjen e mallrave dhe proceseve ose një e ardhme për përdorimin e brendshëm të tyre.
 - ? Ekzistojnë burime adekuate, ose pritjet që ato të gjinden, për ta përfunduar projektin.
3. Pasqyrat financiare duhet t'i shpalosin shumat e hulumtimeve dhe shpenzimet e zhvillimit që janë ngarkuar në shpenzime për atë periudhë, shumën e shpenzimeve të shtyra të zhvillimit të ngarkuara në shpenzime për

atë periudhë, shpenzimet e zhvillimit të shtyra gjatë asaj periudhe, dhe shpenzimet e shtyra të zhvillimit që janë të paamortizuara.

Vini re që informacioni i dhënë më lart nuk gjen zbatim në aktivitetet e specializuara siç janë puna e bërë për të tjerët, ndërmarrja në stadin e zhvillimit, dhe aktivitetet speciale të ndërmarrjeve në industritë nxjerrëse siç është eksploatimi i minierave.

Faktorët që Merren në Konsiderim për ta Paracaktuar Afatin e një Pasurie të Patrupëzuar

Faktorët e mëposhtëm duhet të merren në konsiderim për ta paracaktuar afatin e një pasurie të patrupëzuar:

- ? Provisionet ligjore, rregullative ose kontraktore të cilat mund ta kufizojnë afatin maksimal të përdorimit.
- ? Provisioni për ripërtëritje apo zgjerime i cili mund ta ndryshojë një limit të caktuar në afatin e përdorimit
- ? Efektet e vjetërimit, konsumit apo faktorëve të tjerë ekonomikë që mund ta reduktojnë afatin e përdorimit.
- ? Veprimet e pritura të konkurrentëve dhe të tjerëve që mund t'i restrikojnë përparësitë prezente të konkurrimit.
- ? Një pasuri e patrupëzuar që mund të jetë kompozitë e shumë faktorëve individualë me afate të ndryshueshme të përdorimit efektiv.